



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 19.5.2021

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, datë 19.5.2021, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Kastriot Selita

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, si dhe parashtrimeve me shkrim të paraqitura në seancat gjyqësore të datave 17.3.2021, 1.4.2021 dhe 28.4.2021, të zhvilluara në kuadër të këtij gjykimi, Komisioneri Publik vlerëson se:

I. Për sa i përket kontrollit të kriterit të pasurisë

1. Në lidhje me shkaqet e ankimit për pasurinë “*Apartament me sipërfaqe 124,91m²*”, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, bashkëshortes së tij, Komisioneri Publik konstaton se rrethanat e faktit në përfundim të këtij gjykimi mbetën të njëjta dhe, si të tilla, interpretimi ligjor mbi to, prej palëve pjesëmarrëse në këtë proces, mbetet për t’u çmuar dhe vendosur nga ana e Kolegjit.

1.1 Komisioneri Publik, për sa i takon periudhës së kryerjes së pagesave dhe kostos së ndërtimit të objektit: *shtëpi banimi 2 kate + papafingo¹, me sip. 268 m²*, konstaton se, edhe nga shqyrtimi gjyqësor, rezultoi se pagesat për këtë pasuri janë kryer deri në muajin korrik 2004. Në

¹ Pasuri në pronësi të familjes së bashkëshortes të subjektit të rivlerësimit, shitja e së cilës ka shërbyer si origjinë burimi në blerjen e pasurisë “Apartament me sipërfaqe 124,91 m²”.

lidhje më përcaktimin e kostos së ndërtimit të këtij objekti, nisur nga praktika e përcjellë prej Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, kërkuar dhe administruar si provë nga Kolegji, bazuar në nenin F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se ky institucion ka përlloritur si kosto ndërtimi për këtë objekt, vlerën totale prej 7.241.400 lekë. Në referencë të kësaj vlere të kostos së ndërtimit, të parashtruar nga ky institucion shtetëror, të cilit iu kërkua informacion nga ana e trupit gjykues për efekt të këtij gjykimi, ajo mbetet e ndryshme krahasuar me dy vlera të tjera të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur/të tjerë të lidhur, duke pamundësuar për institucionet e rivlerësimit përcaktimin mbi kritere objektive të shumës së investuar në këtë pasuri.

1.2 Në lidhje me burimin dhe ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, si të përfituara nga fondacioni “**** * ** * **”, në analizë të provave të administruara edhe gjatë hetimit gjyqësor në Kolegji, referuar jurisprudencës tashmë të konsoliduar të këtij të fundit, konstatohet se nuk provohet përfitimi i këtyre të ardhurave për vitet 2002 - 2003, si dhe nuk provohet ligjshmëria e të ardhurave për të gjithë periudhën e pretenduar të punësimit, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

1.3 Për sa i përket shpenzimeve të qirasë dhe të mobilimit të familjes të bashkëshortes të subjektit, vlerësojmë se deklarata noteriale e depozituar nga subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit në Kolegji, për të provuar se nuk ka pasur shpenzime të kësaj natyre, nuk bazohet në të dhëna të tjera objektive.

1.4 Sa i përket shpenzimeve të jetesës të familjes së bashkëshortes së subjektit, Komisioneri Publik, bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e çmon të nevojshme vlerësimin e këtij shkak, duke e lënë eventalisht në vlerësimin e Kolegjit dhënien e një orientimi lidhur me metodologjinë që do të duhet të përdoret për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës para dhe pas vitit 2003.

2. Në lidhje me shkaqet e ankimit për dy pasuritë, “*Apartament me sipërfaqe 29,86 m²*” dhe “*Garazh me sip. 12,5 m²*”, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, Komisioneri Publik, në vijim të sa është argumentuar në parashtrimet përkatëse gjatë seancave gjyqësore të këtij procesi, konstaton se:

2.1 Nga shqyrtimi gjyqësor nuk rezultoi ndonjë provë për të mbështetur pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me destinacionin e kredisë në shumën 23.000 euro, e cila, nga aktet e administruara, rezulton të ketë shërbyer për shlyerjen e huas kundrejt shtetasit * ** . * ** .

2.2 Në lidhje me: (i) shumën prej 20.000 euro, dhuruar bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga familja e saj, që ka shërbyer për shlyerjen e kredisë në vitin 2004, vlerë monetare për të cilën nuk janë paguar detyrimet tatimore, si dhe (ii) shumën prej 18.000 euro, fitim i realizuar nga bashkëshortja e subjektit, nga shitja e apartamentit me sip. 102 m², pagesa e detyrimeve tatimore për të cilat është kryer me vonesë, Komisioneri Publik konstaton se situata faktike mbeti e njëjtë pas shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegji.

2.3 E njëjtë mbetet dhe kërkesa e parashtruar nga Komisioneri Publik, i cili, bazuar dhe në Rekomandimin e paraqitur nga një Komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit,² për të ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, në referencë të nenit 66, paragrafi i dytë, i ligjit nr. 84/2016, i kërkon Kolegjit orientimin e Komisionit në zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, nëpërmjet interpretimit gjyqësor, në lidhje me konsiderimin si të ligjshme, në kuptim të paragrafit 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës: **(i) të të ardhurave për të cilat detyrimi tatimor është kryer me vonesë në vite** dhe atyre **(ii) të ardhurave që burojnë nga dhurime prej personave të tjerë të lidhur, për të cilët nuk është paguar detyrim tatimor.**

2.4 Konstatohet se për çështjen e parë, që lidhet me pagesën me vonesë në vite të detyrimit tatimor për të ardhurat e deklaruara nga subjektet rivlerësues dhe/ose personat e lidhur, Kolegji ka tashmë një jurisprudencë, ndër të tjera, në vendimet e tij nr. 8/2019, nr. 5/2020 dhe nr. 23/2020. Në kuptim të nenit 66, paragrafi i dytë, i ligjit nr. 84/2016, orientimi i Kolegjit për këtë interpretim ligjor të dispozitës së paragrafit 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës, do të ishte shterues dhe detyrues në të ardhmen për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.

2.5 Në lidhje me çështjen që ka të bëjë me të ardhurat që burojnë nga dhurimet e përfituara prej personave të tjerë të lidhur, të ardhura për të cilat nuk është paguar detyrim tatimor, Komisioneri Publik nënvizon se jurisprudenca e Kolegjit, në lidhje me interpretimin e dispozitës së nenit D, të aneksit të Kushtetutës, tashmë është e konsoliduar, duke i konsideruar si kumulative ekzistencën njëkohësisht të burimeve të ligjshme dhe pagesën e detyrimeve tatimore për shumat e rrjedhura nga burimet e ligjshme, në mënyrë që të ardhurat të konsiderohen si të ligjshme për efekt të krijimit të pasurisë nga subjektet e rivlerësimit.

2.6 Referuar kësaj jurisprudence të Kolegjit, përjashtimi nga detyrimi i pagesës së detyrimeve tatimore të të ardhurave të krijuara nëpërmjet burimeve të ligjshme, lejohet vetëm në ato raste kur ka parashikime të posaçme ligjore për përjashtimin e të ardhurave që vijnë nga burime të ligjshme³.

2.7 Duke iu referuar çështjes konkrete, Komisioni, gjatë hetimit administrativ ka administruar korrespondencat e Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në lidhje me ekzistencën e detyrimit eventual për pagesën e tatimit në rastet e vlerave monetare të përfituara në formën e dhurimit, duke konkluduar se krijimi i të ardhurave, duke pasur si burim dhurimin e tyre, duhet të konsiderohet si një ndër rastet e përjashtimit nga pagesa e detyrimeve tatimore.

2.8 Në zbatim të vetë jurisprudence të deritanishme të Kolegjit të lartpërmendur, përjashtimi nga detyrimi i pagesës së detyrimeve tatimore i të ardhurave të krijuara nga burime të ligjshme, bëhet vetëm kur, shprehimisht, ky përjashtim gjen pasqyrim në ligj.

2.9 Sikundër mund të konstatohet nga leximi i legjislacionit, në nenin 8/1, me titull: “*Të ardhura të përjashtuara*”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të ardhurat e përfituara në formën e dhurimit të vlerave monetare, nuk përfshihen në

² Referohuni në pikën 4/1 dhe 5 të Rekomandimit të ONM-së, datë 24.7.2019.

³ Referohuni në prg. 22.12, 22.13, vendim (JR) nr. 19, datë 26.7.2019, i Kolegjit.

kategoritë, për të cilat ligjvënësi të ketë parashikuar përjashtimin nga detyrimi i pagesës së detyrimeve tatimore.

2.10 Për më tepër, në dhjetor 2019, ligjvënësi ka bërë një parashikim të veçantë për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, duke e përjashtuar pagesën e detyrimit tatimor të vlerës së kësaj të ardhure, kur ajo realizohet nëpërmjet dhurimit.

2.11 Konkretisht, me ndryshimet e ndodhura me ligjin nr. 84/2019, nenit 8/1 të lartpërmendur, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, i është shtuar pika 11.1. Në këtë nen janë parashikuar si të ardhura të përjashtuara nga detyrimi i pagesës së detyrimit tatimor, ato që krijohen nga kalimi nëpërmjet dhurimit, të së drejtës së pronësisë mbi pasuri të paluajtshme, banesë/truall brenda familjes (bashkëshort/e, fëmijë), vetëm një herë.⁴

2.12 Përkundër sa ka parashikuar për përjashtimin nga detyrimi i pagesës së detyrimeve tatimore për të ardhurat që realizohen nga kalimi i të drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme, ligjvënësi, edhe në këto ndryshime ligjore, ka heshtur, duke mos përfshirë në rrethin e të ardhurave të përjashtuara nga detyrimi i pagesës së detyrimeve tatimore, të të ardhurave të përfituara në formën e dhurimit, të shumave monetare.

2.13 Thënë ndryshe, që prej miratimit të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ardhurat që realizohen nga dhurimi i vlerave monetare nuk rezultojnë të jenë përfshirë nga ligjvënësi në mesin e të ardhurave që përjashtohen nga pagesa e detyrimit tatimor.

2.14 Në kuptim të nenit 66, paragrafi i dytë, i ligjit nr. 84/2016, orientimi i Kolegjit për këtë interpretim ligjor të dispozitës së paragrafit 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës, do të ishte shterues dhe detyrues në të ardhmen për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme.

3. Në lidhje me shkaqet e ankimit për pasurinë “*Apartament duplex me sipërfaqe 205,33 m² së bashku me truall me sip. 521,8 m²*”, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, Komisioneri Publik, përveç sa kemi argumentuar në parashtrime gjatë seancave gjyqësore, konstaton se:

3.1 Lidhur me burimin e deklaruar të kësaj pasurie, të ardhura nga shitja e apartamentit, me sip. 48.27 m², në Shëngjin, Lezhë, në shumën 35.000 euro, pasuri e cila ka si origjinë, pasurinë e ish-bashkëshortëve Selita⁵, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk u administrua ndonjë provë lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2003, si dhe për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 2.900.000 lekë, përfituar nga pjesëtimi i së njëjtës pasuri, pas zgjidhjes së martesës.

3.2 Sa i përket burimit tjetër të deklaruar, kursime të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në shumën 30.000 euro, përfituar nga dhurimi brenda familjes, Komisioneri Publik konstaton se situata faktike mbetet e njëjtë dhe, sikundër u tha më lart, edhe për këtë shumë, i njëjtë mbetet dhe

⁴ Ky ndryshim ligjor ka gjetur pasqyrim dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku me Udhëzimin nr. 15, datë 3.4.2020, në pikën 2.4, “Të ardhura të përjashtuara”, pas pikës 10 është shtuar pika 10.1.

⁵ Pasuria apartament me sip. 73 m², e ndodhur në rrugën “**** **”, Tiranë.

kërkimi për orientimin e Komisionit në zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, nëpërmjet interpretimit gjyqësor, në lidhje me konsiderimin si të ligjshme, në kuptim të paragrafit 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës, të të ardhurave që burojnë nga dhurime prej personave të tjerë të lidhur, për të cilët nuk është paguar detyrim tatimor.

4. Në lidhje me shkaqet e ankimit për pasurinë **“Autoveturë”**, nga shqyrtimi gjyqësor nuk rezultoi ndonjë provë për të kundërtën e situatës faktike të konstatuar. Për rrjedhojë, përveç sa trajtuar lidhur me ligjshmërinë e shumës 2.900.000 lekë, një pjesë e së cilës⁶ ka shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie, vlerësojmë, se referuar nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, personi tjetër i lidhur, vëllai i subjektit të rivlerësimit, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për t'i dhuruar subjektit shumën 4.000 euro, deklaruar prej këtij të fundit si burim krijimi për blerjen e automjetit.

II. Për sa i përket kontrollit të kriterit të aftësive profesionale

5. Referuar shkaqeve të ankimit, gjatë hetimit gjyqësor, bazuar në nenin F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, të ligjit nr. 84/2016, ky trup gjykues administroi prova të tjera dhe mbi to u debatua gjyqësisht, në vlerësimin e situatës së konstatuar të konfliktit të interesit dhe atij në dukje, përpos vlerësimit të përmbajtjes së denoncimeve të paraqitura nga publiku, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

6. Komisioneri Publik u qëndron parashtrimeve të tij të paraqitura me shkrim në seancën e datës 17.3.2021, 1.4.2021 dhe 28.4.2021.

7. Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit, në ushtrim të funksionit të tij si magjistrat/gjyqtar relator në rastet me palë ndërgjyqëse, shoqëritë **“***” sh.p.k.** dhe **“****” sh.p.k.**, shoqëri me të cilat, si subjekti i rivlerësimit, ashtu dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja, kanë pasur para dhe pas gjykimit të çështjes marrëdhënie juridiko-civile me bazë interesi pasuror, ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, në vështrim të nenit 5 të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe në mungesë paanësie, referuar nenit 72/6 të Kodit të Procedurës Civile.

7.1 Lidhur me çështjet e konfliktit të interesit në dukje, Komisioneri Publik u qëndron shkaqeve dhe parashtrimeve të paraqitura në këtë gjykim, ku në disa raste vlerësohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dorëheqjen dhe në disa raste ka vepruar me vonesë, duke cenuar në këtë mënyrë detyrimin për shmangien e çdo perceptimi mbi paanshmërinë e gjykimit prej tij, situatë kjo e cila duhet të ndikojë në vlerësimin tërësor të çështjes.

8. Për sa i përket denoncimeve të paraqitura nga publiku, Komisioneri Publik u qëndron shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve përkatëse në seancat gjyqësore, duke vlerësuar, përfundimisht, se prapësimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe të bazuara në prova.

⁶ Si një nga burimet për blerjen e kësaj pasurie është deklaruar shuma 900.000 lekë, me burim nga pjesëtimi i pasurisë me ish-bashkëshorten.

9.2 Për kriterin e aftësive profesionale dhe nga vlerësimi tërësor i çështjes, në interpretim të nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2, lidhur me nenin 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit duhet të gjejë zbatim neni 61, pikat 4 dhe 5, të këtij ligji;

9.3 Komisioneri Publik, duke nënvizuar se çështjet e ngritura në ankim, e për të cilat është kërkuar vlerësim dhe orientim nga ana e Kolegjit, paraqesin rëndësi edhe për zgjidhjen e rasteve të ngjashme, në konsideratë të rolit kontrollues dhe orientues, sipas nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ky trup gjykues të shprehet lidhur me to;

9.4 Bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr.161, datë 18.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Selita, magjistrat/gjyqtar, Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA